



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

Mundësi aplikimi për studime parauniversitare pranë “Avicenna International College”, Budapest, Hungari

Avicenna International College ofron studime në Budapest në një program të caktuar të studimeve parauniversitare, si dhe kurse përgatitore 1-vjeçare për të studiuar në programe studimi si: mjekësi, biznes dhe në fusha të tjera teknike. *Avicenna International College* është një institucion i pavarur arsimor që ofron mundësi për studentët e huaj për të ndjekur studimet në programe përgatitore të nivelit “A” (A level), programe për mësimin e gjuhës angleze, duke i pajisur ata me certifikatë të njohjes gjuhësore “Cambridge”. Me përfundimin e këtyre programeve përgatitore të gjithë studentët e huaj mund të ndjekin studimet bachelor në universitetet hungareze, evropiane dhe ndërkombëtare,

Avicenna International College, anëtar me të drejta të plota pranë Federatës së Arsimit në Evropë (Federation of Education in Europe, FEDE), është themeluar në Budapest në vitin 1995 dhe i zhvillon programet e studimit në gjuhën hungareze/ose angleze. Kolegji Ndërkombëtar “Avicenna” (*International College -AIC*) ka një përvojë ndërkombëtare në arsim për më shumë se 25 vjet dhe ofron një model unik arsimor bashkëkohor për gjeneratën e re, sipas standardeve dhe zhvillimeve të arsimit ndërkombëtar përmes edukimit akademik dhe trajnimeve të përshtatshme.

Gjithashtu, *Avicenna International College*, mbështet studentët ndërkombëtarë të talentuar me bursë studimi. Të gjithë kandidatët e interesuar për të studiuar me bursë studimi duhet të plotësojnë *online* aplikimin për përfitimin e bursës, krahas aplikimit për ndjekje të studimeve.

Për më tepër informacion në lidhje me procedurat e aplikimit, kriterëve dhe afateve, ju lutemi referojuni adresave të mëposhtme web:

<https://avicenna.hu/apply-to-ncuk-programs-at-aic/>

<https://avicenna.hu/about-us/>

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS